

Ngatërrimi i kënaqësisë me lumturinë

Të gjithë kërkojnë lumturinë, por shumë, ashtu siç kam bërë unë, ngatërrojnë kënaqësinë me lumturinë. Ka një ndryshim të madh. Më lejoni t'jua shpjegoj.

Karriera ime në biznes arriti majat përtej imagjinatës sime. Kisha një plan për suksesin tim që do të më bënte të lumtur. Qëllimi im ishte të bëhesha aq i suksesshëm, sa të kisha një avion privat dhe të kisha para të mjaftueshme për të shkuar ngado dhe të mos shqetësohesha kurrë për çmimin apo kohën.

Po përfytyroja shkallën time të suksesit. Në majë ishte avioni. Këmba e fundit e shkallës ishte të gjeja punën e duhur. Këmba e dytë e shkallës: të ngrimesha në detyrë. E treta: të blija një makinë të bukur. E katerta: të blija shtëpinë e parë. E pesta: pushime në Hauai. E gjashtë: të isha pronar firme. E shtata: të blija një makinë të dytë, një Mercedes. E teta: të udhëtoja nëpër botë. E nënta: të kisha një shtëpi më të madhe dhe më të mirë në një zonë ekskluzive. E dhjeta: të fitoja shumë para në tregjet financiare. E njëmbëdhjeta: të isha pjesë e një klubit privat ekskluziv. E dymbëdhjeta: të blija një shtëpi pushimi. E trembëdhjeta: të blija një jaht. Dhe kështu me radhë. E keni parasysh. Po shkoja drejt avionit: drejt lumturisë.

Mendoja se kur të arrija në majë, tek avioni, do të isha i lumtur. Por ndodhi diçka me planin tim rrugës. Zotërimet e mia filluan të më zotëronin dhe të më kontrollonin. Martesa u prish. Kisha materialet, por isha gjithnjë e më pak i lumtur.

Më në fund Perëndia më tërhoqi vëmendjen. Ai më përuli dhe hoqi përqendrimin tim nga stili im i jetës që kërkon vetëshërbim dhe kënaqësi. I kërkova Jezu Krishtit të bëhej Zoti i jetës sime dhe pranova dhuratën e Tij të hirit për të rregulluar marrëdhënien time me Perëndinë.

Mësova se kishte një ndryshim të madh dhe të thellë midis kënaqësisë dhe lumturisë. Kisha shumë kënaqësi, çdo ditë. Isha i ri, në të dyzetat dhe isha i pasur. Isha mik dhe partner biznesi me Xhon Uejnин. Kisha shoqëri me njerëz të bukur në Newport Beach, Kaliforni. Më ftonin në të gjitha mbrëmjet "fantastike". Por, dhe kjo POR është e madhe, nuk isha i lumtur, sepse kënaqësia dhe lumturia më tërhiqnin në krahe të kundërtta.



Perëndia më ndryshoi përparësitë. Zbrita shkallët e suksesit dhe u mbështeta në një mur tjetër. Ai mur "tjetër" po kërkonte Perëndinë dhe vullnetin e Tij për jetën time.

Mësova se nuk ka lumturi pa paqen me Perëndinë. Po kërkova lumturinë në gjërat e kënaqësisë, ndërkohë që, duke mos pasur paqe me Perëndinë, nuk kisha qenë i lumtur. Sapo u pajtova me Perëndinë dhe pata paqe me Të përmes Birit të Tij, Jezu Krishtit, kërkimi im për lumturi përfundoi. Përjetova paqe të plotë me Perëndinë pavarësisht nga natyra ime mëkatare dhe kështu erdhi lumturia: lumturi e gjatë dhe reale.

Sapo ndodhi diçka e tillë në jetën time dhe isha në paqe, nuk po kërkova më gjëra materiale. Që prej asaj kohe kam qenë i lumtur, i lumtur me paqe në zemër dhe në çdo rrethanë, nga ana financiare dhe fizike, edhe pse në 1993-shin më thanë që kisha një sëmundje të pashërueshme dhe vdekjeprurëse dhe më mbetej vetëm një vit për të jetuar. Lumturia ime është e përhershme. Ajo nuk ulet apo ngrihet si tregjet financiare, vlera ime neto apo shëndeti i padëshirueshmë.

Vargu më i pëlqyer i Shkrimit është ky: "Të shfajësuar, pra, me anë të besimit, kemi paqe me Perëndinë nëpërmjet Jezu Krishtit, Zotit tonë" (Rom. 5:1).

Gjërat materiale janë të mira. Ato sjellin shumë kënaqësi. Më pëlqen t'i kem. Por nëse një person kërkon lumturi, ajo vjen vetëm kur kemi paqe me Perëndinë dhe ajo vjen vetëm duke vendosur besimin në Jezu Krishtin.

Shiko këto vargje nga Shkrimi:


Mos u shqetësoni për asgjë, por, në çdo gjë, ia parashtroni kërkesa tuaja Perëndisë me anë lutjesh dhe përgjërimesh, me falënderim (Filipianëve 4:6).

(Fjalët e Jezusit): "Unë po ju lë paqen, po ju jap paqen time: unë po jua jap, po jo si e jep bota; zemra juaj mos u trondittë dhe mos u frikësoftë" (Gjoni 14:27).

Kur kemi paqe me Perëndinë, paqja e Krishtit do të sundojë zemrat tona. Ne nuk kemi pse të fitojmë paqen e Perëndisë. Jezusi na e jep falas, nëse ne do ta pranojmë. Kënaqësia e botës nuk sjell paqe me Perëndinë apo lumturi. Lumturia është paqja me Perëndinë përmes një marrëdhënieje me Jezu Krishtin. Dhe ky është *Krishterim i vërtetë*.

Nga Ken Willig

Marrë nga libri i tij: *Dhurata falas, Udhëtimi i një personi nga feja në një marrëdhënie me Perëndinë [The Free Gift]*.



FALJA,

një fjalë kaq rrëqethëse

Hyjnora Falje. Fjalë kaq pajtuese mes njerëzve, kaq domethënëse e me vlerë jetike në çdo marrëdhënie njerëzore. Ajo i lë dyert e hapura ndaj çdo marrëdhënieje njerëzore, sado e vështirë të ketë qenë ajo. Ai që e ka themeluar dhe praktikuar për herë të parë faljen është Krijuesi ynë. Jezusi na fali atëherë kur ishim shumë larg me mëkatin tonë. Ai e bëri këtë vullnetarisht, edhe pse e dinte që kjo do t'i kushtonte. Jezusi tha ndërsa ishte në kryq, "U krye; Atë, fali ata, sepse nuk dinë se ç'bëjnë". Në atë vuajtje aq të paimagjinueshme, ku vetë Ati e braktisi, sepse duhej të mbartte mëkatet tona, vuajtja më e madhe e Jezusit ishte ajo shpirtërore.

Ne si njerëz nuk do të mundemi ndonjëherë të kuptojmë sa vuajti ai për ne, që ne të faleshim për ato që meritonim të ndëshkoheshim. Çfarë mëshire, çfarë hiri, çfarë dashurie e paparë ndonjëherë, ç'mrekulli e pashpjegueshme për ne! Për shkak të krenarisë sonë si njerëz, shpesh e kemi të vështirë të falim, të flasim hapur për çfarë na shqetëson, të dëgjojmë personin që na flet, sepse duam të shfajësohami para tij. Ne, krijesa plot dobësi, e kemi kaq të vështirë të falim, sa zgjatim situatat e pakëndshme mes njerëzve që të mos shkojmë drejt faljes. Madje na duket kaq larg të falim atë që na dëmton sikur të ishim Zoti vetë.

E çuditshme por reale – Ai na fali kur nuk kishte asgjë të mirë në ne, ndërkohë që Ai vetë ishte i përsosur. Jezusi është Zoti, shenjtëria dhe pastërtia e Tij janë absolute, e megjithatë Ai nuk na trajtoi si krijesa të pista edhe pse ishim të zhytur në mëkatin tonë. Jezusi na çmoi më shumë se veten e Tij e na fali. Çfarë hiri! Jo vetëm që nuk na dënoi, por shkoi përtej çdo fantazie tonën,

duke na bërë një dhuratë të pamerituar, duke këmbyer dënimin e përjetshëm me parajsën për ne.

Me ndihmën e Tij mund të lirojmë shumë njerëz prej fajit të tyre, duke i falur pa kushte pa masë jo 1, 2, 7, 49 herë, por çdo herë që mëkatojnë ndaj nesh. Kam parë njerëz që prej faljes së dikujt kanë kaluar në faljen hyjnore dhe i janë shtuar familjes së Zotit. Sa bukur kur shohim me gëzim drejt Atij që na fali dhe harrojmë të keqen që na kanë bërë të tjerët. Sa bukur kur kupton që i burgosuri ishe ti që ushqejë zemërim për diçka kaq pa vlerë përballë dhuratës së faljes që Krishti të bëri ty.

Sa e mrekullueshme të shohësh fytyrën e dikujt që i kanë falur borxhin, aq i çliruar, aq i gëzuar e në paqe, sepse nuk do t'i dalë përpëra dikush që do ta kërcenojë. Sa bukur është ta rifillosh jetën aty ku je, pa pengje e borxhe, pa frikë e ndroje por me një gëzim që të shkëlqen nga larg. Sa bukur të shohësh dy njerëz që falin gjaqet e tyre, i jatin dorën njëri-tjetrit dhe fjalën që nuk do të marrin hak për këtë, sepse hakmarrja i takon Zotit tonë. Sa bukur të shohësh dy njerëz që duhen të falin njëri-tjetrin, apo prindër që falin fëmijët e tyre, apo vëllezër e motra që falin njëri-tjetrin. Sa bukur kur sheh dy drejtues qeverish të jatin dorën e bashkëpunimit edhe pse paraardhësit e tyre i kishin thyer këto marrëdhënie. Sa bukur që çdo ditë të jetosh me faljen e Krishtit dhe me gëzim në zemër.

Nga
Adelina Çiplaka



*“Nëse të gjithë
do të ishin si
çunat tuaj, ne
do t’i linim
çelësat dhe do
të iknim në shtëpi”,
- theksoi njëri nga
punonjësit e policisë
së burgut, kur shkuam
për të zhvilluar kursin e
radhës “Udhëtimi i
të Burgosurit” në burgun
e Rrogozhinës.*

Shërbesa në burgje është një inkurajim për të gjithë ata që janë të përfshire, por mund të jetë edhe sfidë në të njëjtën kohë. Mund të përjetosh mrekullinë e të drejtuarit njerëz të tjerë te Krishti dhe t’i shohësh ata të rifillojnë jetën e tyre në mënyrë të efektshme për shoqërinë dhe një jetë që i pëlqen Perëndisë.

Një pjesë e mirë e punës që bëjmë mbështetet fuqimisht nga shumë vullnetarë që kanë një zemër për t’u shërbyer të dënuarve. Besojmë se ata janë zemra e kësaj shërbese. Ti sheh lutje që marrin përgjigje në kohë dhe mënyrë të mrekullueshme, gjë e cila forcon jetën dhe besimin tënd personal. “Isha shumë e renduar atë ditë... por vendosa të shkoj në burg. Kur dola prej aty, isha mbushur plot gëzim...” - shprehet një nga vullnetaret tona pas shërbesës në burgun e grave.

Si vullnetar në burg, ti u shërben të gjithë të dënuarve pa i paragjykuar ata.

Kur ndodh që dikush hap zemrën për Zotin, ti kupton më shumë natyrën njerëzore, pasojat e mëkatit dhe rolin unik të Krishtit, i cili na bën kriesa të reja. Ka madje edhe të dënuar që shprehen se dënimini me burg “ishte gjëja më e mirë që më ka ndodhur”, sepse aty ata kanë takuar Krishtin.

Një kishë misionare në çdo burg?

Shpresë pas hekurave

Duket në skajet e të pamundurës, por Zoti të cilit i besojmë, gjërat e pamundura i bën të mundura. Pavarësisht sfidave, ti sheh punën e mrekullueshme të Frymës së Shenjtë dhe kupton se je duke u shërbyer adhuruesve, pastorëve, mësuesve dhe shërbëtorëve të ardhshëm. Mahnitësh nga etja dhe lira e shpirtit, pavarësisht mureve dhe hekurave. Nga muret e burgut ti dëgjon këngë adhurimi për Krijuesin tonë. Shkon për të shërbyer, por njëkohësisht shërbëhesh pasi ndien në shpirtin tënd se “më i bekuar është ai që jep sesa ai që merr”.

“Shoqëria Kristiane e të Burgosurve të Shqipërisë” Sh.K.B.Sh, që prej vitit 2002 shërben Fjalën e Zotit në burgjet e Shqipërisë.

Misioni ynë është “Të ndajmë ungjillin e Jezus Krishtit me të dënuarit, fëmijët dhe familjet e tyre, të thyejmë qarkun e varférish dhe të pamundësish duke qenë një ndihmë për kishën lokale”.

Me një skuadër prej 19 anëtarësh, ndajmë ungjillin në burgje disa herw në javë. Së bashku me 100 vullnetarë nga kisha lokale, zhvillojmë programe të ndryshme ungjillizuese dhe dishepullizuese për të dënuarit. Zhvillojmë gjithashu programe sociale me familjet dhe fëmijët e të dënuarëve jashtë burgut.

Në sistemin Penitenciar janë 23 Intitucionë të Vendimeve Penale (burgje). Ne shërbejmë në 19 prej tyre. Së bashku mund t’u shërbejmë më mirë atyre që kanë më shumë nevojë për jetën që Zotit jep, si dhe t’u ofrojmë mbështetje praktike.



Listën time të hakmarrjes e mbaja ende në xhep

(Dëshmi nga burgu)

Kisha përgatitur një listë të gjatë për kundërshtarët e mibranda dhe jashtë burgut: "këtij do t'i djeg shtëpinë, atij do t'i shpërthej makinën, këtij do t'i bëj këtë e atij tjetrit atë..." Kjo ishte lista ime e hakmarrjes. Po bëja plane si t'i rrjhja kur t'i shihja, dhe mezi prisja rastin të më dilnin në shteg. Disa njohje i kisha kur të dilja nga burgu dhe mund të hakmerresha lehtësisht kundra kujtdo që kisha planifikuar.

Në bibliotekën e burgut të Durrësit takoja herë pas here një të dënuar besimtar. Mua më pëlqente të lexoja. Ai nisi të më fliste për herë të parë për besimin dhe më dhuroi një Bibël. Një ditë isha shumë i mërzitur, shkova në qeli, hapa Biblën dhe nisa të lexoj nga libri i *Fjalëve të Urta*. Më bëri përshtypje se si një libër i shkruar rreth 2000 vjet më parë, të ishte kaq aktual me situatën që unë po kaloja.

Disa muaj më vonë më transferuan në burgun e Rrogozhinës. Pyetja e parë që bëra, ishte nëse kishte kishë aty në burg. Polici më tregoi se kishte një kishëz të vogël. Nisa të shkoj rregullisht në takimet që zhvilloheshin nga kapelani dhe të dënuar të tjerë, por një pjesë e madhe e shkrimit më dukej e pakuptimtë.

Listën time të hakmarrjes e mbaja ende në xhep... planet i kisha gati... Besimi tek Zoti kishte filluar të më pëlqente, por nuk po shihja ende ndryshim tek vetja. Kapelani na foli një ditë për jetën e Jozefit dhe gjithë peripecitë që hoqi nga vëllezërit e tij. Dhe se si në fund Jozefi i fali ata të gjithë. "Ja, vëllezër, këtu është një thes i madh, Jezusi ju fton që të hidhni këtu gjithë hakmarrjen dhe zemëraten tuaj, hidhini këtu sepse është barrë e rëndë për ta mbajtur ju vetë", - vazhdoi ai.

Atë ditë vendosa që ta hedh listën time të hakmarrjes tek ai thesi, duke falur këdo që më kishte lënduar. Në atë moment ndjeva se shkarkova

një barrë shumë të madhe dhe isha mbushur tërë gjësim! Jeta dhe dëshirat e mia filluan të ndryshon. Fillova të lexoja Ungjittë në Bibël si dhe libra të tjerë për besimin. Besimi im filloi të rrjetë dhe kisha një dëshirë të madhe për t'u pagëzuar.

Disa muaj para se të lirohesha isha në dilemë se si do të ishtejeta jashtë. E dija që kisha shumë borxhe për të larë dhe i thashë kapelanit: "Epo, s'jetohet kështu... do t'i marrë leje Zotit për një muaj, do dal në Evropë, do bëj ca lekë të marr një makinë, dhe pastaj do vij t'i shërbjej Zotit." Ai qeshi dhe më tha se nuk bëhen planet kështu... por me besim.

Më vonë bëra një kërkësë në gjykatë për ulje dënimini. Kisha bëre disa plane si ta arrija këtë në mënyrë të pandershme. Në moment më kapi ndërgjegja, dhe vendosa: "Jo, nuk do të bëj korruption! Unë jam besimtar." Mu kujtua vargu: "Të tjerët do t'ju njohin nga veprat që bëni..." Nuk doja të nxisja korruptionin. Vendosa të flisja me shokun tim aty në burg. Ai më tha: "Po ne këtë kemi edhe besojmë, dhe dëshirojmë ta ndryshojmë vullnetin e Zotit me para. Ti lutu, dhe po je gati, Zoti do ta bëjë, po nuk je gati do të dalësh pak më vonë, por po të kapën do të vuash më shumë në burg."

Mora në telefon familjen dhe e njoftova, që të merrnin paratë mbrapsht. Ata u shqetësuan, por unë isha i bindur që nuk duhet të jepja para. Të nesërmend shkova në gjykatë. Në dosjen time kisha certifikatën e programit "Udhëtimi i të Burgosurit", së bashku me vërtetimin e shkollës dhe përbajtjen e ligjit. Disa anëtarë të komisionit të burgut i kisha kundër. Mora fjalën ndër të tjera: "Inderuar trup gjykues, gjatë kohës në burg kam filluar të besoj tek Zoti, dhe jam penduar në radhë të parë për vreten time dhe më pas para jush. Nëse ju më ulni qoftë edhe disa javë, kjo

më ndihmon që të mos humbas vitin shkollor." Trupi gjykues u tërroq dhe doli me një vendim: "Ulje dënim i në masën 30 ditë!"

Zemra ime u mbush me gjësim! Atë natë nuk më zinte gjumi. Zgjohesha, falenderoja Zotin, më zinte gjumi, zgjohesha sérish dhe lutesha. Zotin e di se për çfarë ne kemi nevojë, madje para se ne t'i kërkojmë diçka. Tani unë shkoj përsëri në burg, por jo më si i dënuar, por si i çliruar! Gati për të ndarë mesazhin jetëndryshues të Ungjillit me ata që kanë më shumë nevojë.

*Kapelan – Pastor për burgjet

Nga burgu i grave:

Tani unë e di se në sytë e Zotit kam vlerë dhe jam e çmuar.

Kam kaluar një jetë plot me sfida dhe mëkate të shumta. Për çdo gjë të keqe që bëja, isha shumë krenare. Përpinqesha t'i plotësoja dëshirat vetë, pa ndihmën e Zotit.

Kur erdha në burg,jeta ime mori një tjetër rrjedhë. Po kaloja shumë ditë të vështira, isha ndarë nga familia dhe fëmijët e mi.

Aty në burg vinin disa motra të krishtera, të cilat me folën për Jezusin dhe më dhuruan një Bibël. Fillova të lexoja dhe pranova Jezusin si Zotin dhe Shpëtimtarin tim. Fillova t'i lutem Atij që të më drejtonte dhe të ndryshonte jetën time.

Çdo gjë që për ne njerëzit është e pamundur, me Perëndinë është e mundur. Edhe sikur 100 vjet burg të bëj, unë jam e qetë sepse Zoti është me mua. Unë dua dhe do t'i shërbjej Atij kudo që të jem.

Zoti mua më do dhe më gjëzon zemrën çdo ditë, unë dua që të jem një shërbëtore e Zotit gjithë ditët e jetës sime. Nuk rroj më unë, por Krishti rron në mua. Jeta ime ka ndryshuar.

"Zoti është kështjella ime, mburoja ime."

.....
“Ku është Perëndia në të gjitha këto gjëra të këqija që po ndodhin në jetën time?” Kjo pyetje më shoqëronte çdo ditë në burg.

Fillova të shkoj në shërbesat e krishtera në burg, nuk e kuptoja mjafë mirë në fillim se çfarë flitej, por fillova të lexoja Biblën. Shumë shoqe vinin në dhomën time dhe përpinqeshin të më ndihmonin. Ato më inkurajonin, duke më treguar dashuri, por paqen e vërtetë e gjeta vetëm duke lexuar Biblën.

Çdo herë që lexoja, diçka më prekte zemrën. Vazhdova ta lexoj Biblën çdo ditë, kur hapa faqen tek libri i Jobit, unë u inkurajova kaq shumë ngajeta e tij. Jobi kishte kaluar

nëpër vuajtje të tillë si unë, por ai kurrë nuk e mallkoi Perëndinë!

Tani e kuptoj se nuk është faji i Perëndisë për gjërat që më ndodhën mua, por i mëkatit që ishte brenda meje.

Unë besoj në Jezusin, e di që jam lindur sërisht dhe i besoj Atij. Fillova studimin e Biblës dhe jam e lumtur ta studioj Fjalën e Perëndisë. Në burg jemi përballur me situata të vështira, por vetëm besimi në Zot, duke u lutur dhe duke studiuar Biblën, është forca ime e përditshme.

.....

Lutje nga një zemër e çliruar:

“Unë lutem për gjithçka Jezus, edhe për gjëra të vogla personale ... madje Zot unë lutem për ankthin

tim, trishtimin dhe stresin që kam, (më duket sikur po çmendem prej tij) të lutem hiqe atë. Ti je i vetmi Zot të cilit i besoj, ti je Zoti që më jep frymë për të jetuar dhe Zot unë dua të jetoj ashtu siç Ti dëshiron... po përpinqem të kuptoj më shumë për Ty, për Biblën, Jezusin, dhe fjalët e mësimet e Tua. Dua të kem paqe në zemrën time ashtu siç Ti dëshiron, dua të jem e fortë dhe të beso tek Ti.

E di që jam mëkatare, pendohem për gjithçka kam bërë gabim në jetën time dhe kërkoj falje për mëkatet e mia. Më tërhiq pranë Vetes, pranë njoburisë Tënde, pranë dashurisë Tënde të ëmbël. Amen, Haleluja!”

Perëndia nuk më ka harruar

Do të këndojo o Perëndi
Që kurrë s'harron tek unë të vish
Do të lavdëroj, jo s'do të rri
Ti jep shumë forcë e dashuri

Ti jep gëzim, ndër edhe shpresë
Na bën të denjë që të ngadhnjejmë
Mbi çdo pengesë edhe stuhi
Ne nuk humbasim se je Ti
Ref...
Kur shi të bjerë, kur erë të fryjë
Nuk do t'kem frikë se jam me Ty
Ti pranë më... ”

Gjithë ju që besoni

Me gëzim ngadhënyeshëm
Shpejtoni, shpejtoni në Beth
Mbreti i engjëjve
sot ndër ne ka lindur
Ref...

Të shkojmë ta adhurojmë
Të shkojmë ta adhurojmë
Të shkojmë ta adhurojmë
Jezusin Zot!

Vërtet Perëndia, drita e Përjet
Porsi një njeri, pa mëkat e pa
Nga një e virgjër, k'tu në botë
Ref...



Frika që u kthye ne Besim!

Në fëmijerinë time të hersh me isha një fëmijë që nuk kisha frikë nga asgjë, as nga kafshet, as nga errësira, ndryshe nga pjesa më e madhe e fëmijëve të vegjël. Por, për shkak të natyrës time të ndjeshme, kjo gjë u kthye në krejt të kundërtën. Fillova të kem frikë shumë nga errësira dhe nga e ardhmja. Përveç kësaj, duke kaluar nga fëmijëria në adoleshencë, kisha shumë pyetje në mendje që nuk u gjeja përgjigje, një nga të cilat ishte: "Pse kemi lindur dhe ku do shkojmë pasi të vdesim?" Ishte një pyetje që pak fëmijë e çojnë nëpër mend.

Ndërsa kisha pyetje të ndryshme në mendje që vinin edhe iknin, kjo pyetje nuk largohej asnjëherë nga mendja ime, derisa një ditë e gjeta përgjigjen. Por derisa e gjeta u desh pak kohë. Kjo kohë nga *Pyetja* deri tek *Pergjigja* ka qënë një sfidë e madhe për mua, për shkak se nuk gjeja një arsy pse duhet të jetojë dhe nuk gjeja paqe dhe gëzim, dhe kjo për shkak se nuk kuptoja arsyen e jetës. E çuditshme për një fëmije në moshën time (10 vjeç), por e vërtetë!

Në një kohe krishtlindje, isha duke parë filmin e Jezusit, në stacionin e vetëm TVSH që ekzistonte në fshatin e Pogradecit ku ne jetonim. Pasi e kam ndjekur me shumë vë-

mendje të gjithë filmin, më tërhoqi vëmendjen mënyra sesi Jezusi shëronte të sëmurët. Nuk mund ta kuptoja se si një njeri mund të shëronte dikë tjetër në atë formë që vetëm Jezusi e bën. Ndërkohë që të gjithë fëmijët kanë dëshirë të bëhen dikush kur të rriten, dëshira ime ishte të bëhesha si Jezusi. **Por, atë që nuk mund ta kuptoja dhe më lëndonte ishte, pse ai duhej të rrihej dhe të vdiste kur bënte kaq gjëra të mira!?**

Në ato kohë u hap një kishë ungjillore në fshatin ku mami kishte lindur. Motra ime shkonte shpesh për shkak se kishte një marrëdhënie shumë të afërt me tezën e vogël, dhe keshtu ajo shkonte edhe në kishë. Pasi kthehej në shtëpi, këndonte dhe lexonte fshehurazi Biblën. E kam dëgjuar një ditë duke kënduar Psalmin 23 dhe fillova të kem akoma më shumë frikë, sepse nuk e kuptoja, edhe pse kisha shkuar pak herë në të njëjtën kishë me motrën.

Kur unë isha 12 vjeçe, në vitin 2003, ne u zhvendosëm në Durrës për një jetë më të mirë, këtu ku jetojmë edhe sot. Po jetoj me mamin dhe motrën më të madhe, sepse babi dhe vëllai punonin në Greqi për të siguruar për ne. Kur shkuam në Durrës, daja na ftoi të shkoim në kishë me të. Nuk kishim dëshirë të madhe, por filluam

të shkojmë herë pas here, me shkëputje.

Fillova të lexoja Biblën dhe të pyesja për Zotin, Jezusin, dhe më pas gjeta përgjigje për pyetjet e mia, që Zoti na ka krijuar për një qëllim, dhe nëse ne besojmë në Birin e Tij Jezusin, Zotin dhe Shpëtimtarin tonë, atëherë ka shpresë për ne. Dhe pasi lexova Biblën, kuptova filmin që kisha parë kur isha e vogël, që Jezusi vdiq në kryq për mëkatet tona, për shkak të dashurisë së tij të madhe për ne. Por, përveç kësaj, kuptova që jeta merr kuptim, dhe gëzimi dhe paqja e plotë erdhën në jetën time. Nëse ne i rrëfejmë mëkatet tona dhe pendohemi, e kërkojmë Atë me gjithë zemër, Ai do të na i falë mëkatet dhe atëherë Ai do të bëhet Shpëtimtar i jetës sonë, sepse Ai është e vetmja rrugë shpëtimi për njerëzimin.

Lutem që të gjithë të njojin Zotin e Zotërve dhe Mbretin e Mbretërve, Jezus Krishtin, ashtu sikurse unë e kam njojur dhe e besoj. Faleminderit që e lexuat dhe shpresoj jeni inkuruar. Paqja e Zotit goftë me ju të gjithë!

Nga Diana Proga

Jeta është e pashpresë, apo jo?

Nga Maureen Williamson

Shumë njerëz besojnë se klima në Lindjen e Mesme dhe në Izrael në mënyrë të veçantë, është e ngrrohtë dhe me diell gjatë gjithë vitit. Më lejoni t'ju zhgënjej. Në dimër, veçanërisht në Jerusalem, është ftohtë! Jerusalemi është lart rreth 800 metra mbi nivelin e detit, dhe megjithëse temperatura vetëm me raste bie nën pikën e ngrirjes, erërat janë të ftohta dhe therëse.

Në një ditë të tillë veçanërisht të ftohtë, unë isha mirënjohej që kisha përfunduar pazaret dhe isha duke qëndruar me grupin e njerëzve në pritje të autobusit Nr. 4 që do të më conte në Ramat Eshkol, periferia e Jerusalemit ku unë jetoja dikur. Të gjithë sa më zinin sytë ishin veshur me rroba të trasha dhe shumë të errëta dhe ishte një ditë në të cilën do të kishte qenë e lehtë të bije pre e kthetrave të depresionit. Era gjithashtu dukej sikur më priste me aq lehtësi si një reze lazer, duke lënë gjurmët e saj të akullta në çdo shtresë të brendshme të trupit tim. U ngjesha më shumë mes njerëzve përqark meje.

Ju lutem, vini re që në Izrael njerëzit nuk rrinë në radhë për autobusin, por presin ulur apo në këmbë aty përqark derisa ai të shfaqet. Pastaj ndërsa mbërrin në stacion, njerëzit sulen përpara dhe, ashtu si pa kujtar, vrulli të rrëmbejn derisa gjendesh brenda autobusit. Për ta hequr mendjen nga parehatia, po hidhja sytë përqark meje. Ndoshata mund ta përdorja kohën në mënyrë të



mençur duke lexuar tabelat e dyqaneve dhe kështu të praktikoja hebraishten time. Ia dola me sukses me një apo dy, por sikur u dekurajova shpejt. Fjalori im ende nuk ishte edhe aq i pasur.

Pastaj vëmendjen ma tërroqi një grumbull plaçkash përtokë në anën tjetër të rrugës. Ishte një pamje shumë e pazakontë, meqenëse njerëzit në Izrael janë shumë të kujdeshëm në lidhje me sigurinë dhe valixhet e lëna pa një person aty afér, do të bën që njerëzit të fillonin të pyesnin njëri tjetrin, "Tuajat janë këto?", derisa pronari të gjendej, ose, nëse askush nuk u dilte për zot, atëherë menjëherë lajmërohej policia. Shumë jetë janë shpëtuar në këto vitet e fundit nga një vigjilencë e tillë nga ana e kalimtarëve të rastësishëm. Policia arrin shumë shpejt dhe merret me efikasitet me objektin, duke dërguar robotë për të zbuluar materialet brenda pakos, dhe pastaj, ose e shqyrtojnë duke e prekur me kujdes, ose e shpërthejnë

në mënyrë të kontrolluar. Megjithatë, në këtë rast, një shikim i dytë përmua mjaftoi që të shoh se, në fakt, nuk ishte thjesht një grumbull plaçkash, por një burrë krejt i palëvizshëm dhe që dukej shumë i brengosur.

Nuk sheh shumë lypës nëpër rrugë sot, dhe shumë shpejt fillon t'i njoħeħ ata që dalin për të lypur. Disa lypin përvete, nderkohë që të tjerë lypin për ndonjë bamirësi dhe e mbajnë përvete një përqindje të asaj që munden të mbledhin. Disa kënaqen kur kalimtarët ndalen, dhe u japid muhabet shumë vetëve që njobin, nderkohë që ka të tjerë që nuk njobin tjetër lloj jete. Unë mendoja se i njihja të gjithë lypësit, të paktën përvete kaluar ditën me ta, por ky ishte fytyrë e re. Që nga ana tjetër e rrugës mund të shihja që ai nuk ishte nga këto anë dhe pozicioni i lëshuar i kokës së tij më prekte çdo tel të zemrës. Një vërshim ngazëllimi më

përshkoi. Ja ku ishte me të vërtetë dikush që kishte nevojë që të dinte se Jezusi e donte atë, aq sa kishte vdekur për të, dhe që kishte nevojë ta dinte këtë pikërisht tani. E megjithatë autobusi duhej të mbërrinte nga çasti në çast, dhe unë kisha një takim për të mbajtur në anën tjetër të qytetit. Qfarë dileme!

E gjeta veten duke ecur drejt anës tjetër, por ndala dhe u bëra një analizë gjérave. "Zot," thirra. "Nëse kjo është vërtet prej teje, atëherë të lutem bëj që të lirohet trafiku dhe mbaje autobusin Nr.4 larg."

Menjëherë, u shfaq, trafiku u lirua dhe autobusi ende nuk po dukej. U hodha shpejt në trotuarin tjetër dhe me një buzëqeshje triumfi në fytyrë iu afrova burrit për të cilin Krishti kishte vdekur, dhe që qartësish nuk e kishte idenë e asaj sakrifice dhe dashurie. Në qafë i varej një copë spangojo e pistë dhe kapur në të ishte një copë kartoni mbi të cilën ishte shkruar në anglisht dhe hebraisht, "Më ndihmoni! Jam pa para!".

Unë kurrë nuk përdor të njëjtën përqasje dy herë në asnë nga detyrat e krisura që marr përsipër për Zotin. Këtë herë iu afrova atij dhe dëgjoj veten duke i thënë, "Përshëndetje!". Ai mund të kishte qenë në gjumë me gjithë reagimin që pati ndaj meje, ose edhe i bërë krejt dru mendërisht prej drogës. As u drodh e as e ngriti kokën sikur një centimetër. Unë u ula pranë tij me pallton time të çmuar dimërore që një cep i zhyhej në një pellg uji. "Ç'kemi!", i them, dhe zgjas dorën që të prek kokën e tij blonde. Përsëri asnë reagim. Ç'të bëja tjetër?

"Unë e kam emrin Maureen. Jam e krishterë dhe për shkak se jam e tillë, merakosem për ty", i them me vendosmëri. Ai ngriti kokën dhe më pa për një fraksion sekonde para se të rikthehej në pozicionin e tij të pashpresë. Epo, të paktën tani e mora vesh që ishte zgjuar. Paksa më e inkurajuar, e pyeta, "Si e ke emrin?".

Një pushim i gjatë pasoi dhe pastaj, "Badi",

u përgjigj ai.

"Jezusi më ka dërguar që të them se Ai të do shumë", i thashë me guxim të madh.

"Ha, ha!". Këtë herë zgjati pak më shumë kohë para se ta lëshonte përsëri kokën poshtë.

Fillova të vë re më shumë njerëzit rrith e përqark nesh. Shumica nxitonin, të ngutur për të mbërritur në shtëpitë e tyre larg të ftohit të lagësht, dhe ne ishim duke shkaktuar, jo një bllokim, por me siguri një ngadalësim të rrjedhës së kalimtarëve në atë anë të rrugës. Kishte goxha murmurima në gjuhë të ndryshme ndërsa ata manovronin anash nesh. Tani, më vinte keq që po i pengonim, por çfarë ishin pak momente vonese krahasuar me mundësinë për ta tërhequr këtë njeri të trishtuar e të mjerë pranë Jezusit, që mund ta çlironte atë? Ula kokën duke e parë përsëri dhe këtë herë vura re që ai kishte një gotë plastike anash tij, në fund të së cilës kishte disa monedha.

"Nga vjen ti?", ishte pyetja ime e radhës.

Për ngazëllimin tim, ai m'u përgjigj, duke thënë, "Irlanda, dhe dua të kthehem prapë atje sa më shpejt të mundem".

Mendova se ndoshta e kishte shtuar racionin e tij ditor të fjalëve kur papritur ai shtoi, "Mos e humb kot kohën duke folur me mua. Nuk ia vlej".

Tani isha lodhur duke folur me majën e kokës së tij, kur papritur e gjej veten me duart nën mjekrën e tij. Me fare pak mundim e ngrita fytyrën e tij në një pozicion më natyral. Ai m'i nguli sytë krejt i shastisur.

Unë besoj që kushdo, çdo qenie njerëzore është e rëndësishme për Perëndinë, dhe vërtet është e dhimbshme kur shikoj dikë në një gjendje të tillë duke u ndier i pavlerë dhe i parëndësishëm. Unë e di që Perëndia trishtohet nga një gjë e tillë. Rrëmbimthi i thashë me ngut dhe pasion, "Jezusi mendon se ti ia vlen. Ai vdiq në kryq për ty që të të tertiqte te vetja e Tij. Më beso, ky është mesazhi më i rëndësishëm që do të dëgjosh ndonjëherë."

Ai nuk e uli kokën këtë herë,

megjithëse unë i kisha larguar duart, dhe pashë që sytë e tij të bukur blu ishin përlotur. "Jezusi më ka dërguar të them se Ai dëshiron të kujdeset për ty," vazhdova unë. "Në vend që të bësh këtë që je duke bërë, Ai dëshiron që ti t'i thërrasësh Atij. Ai dëshiron ta mbushë jetën tënde me gjëzim dhe të të rikthejë në Irlandë, dhe shumë më tepër se kaq. Ai po troket në derën e zemrës tënde, dhe varet nga ti nëse dëshiron që ta ftosh atë në jetën tënde".

"A je prej vërteti ti?" pyeti ai, dhe zëri i dridhej nga emocioni.

"Këtë nuk e di," i thashë duke qeshur. "Por e di që ky është një takim hyjnor, dhe gjithçka që unë po bëj është të jem lajmëtar, që të sjell te ti Fjalën e Perëndisë. Unë po të tregoj të vërtetën e Tij, dhe Ai vetë më ka dërguar te ti për të ta treguar këtë".

"A do të thuash që Perëndia do ta bëjë këtë për mua?", më pyeti pastaj Badi.

"Më beso," i thashë, me një buzëqeshje siguruese. "Ky do të ishte vetëm fillimi i asaj që Ai ka plan të bëjë për ty".

Në entuziazmin tim ia godita gotën e tij plastike që fluturoi tutje nëpër trotuar. "Ti nuk ke nevojë për këtë gotë të shpifur", i thashë. "Por nëse e pranon këtë mesazh, të garantoj që gjërat nuk do të janë më kurrë njëlljoj!".

Papritur, u duk sikur doli dielli. Badi më buzëqeshi me një buzagaz dashurie, dhe së bashku u ngritëm drejt në këmbë. Kokën e mbante lart ndërsa ai dystonte rrobat dhe têrheq poshtë shkrimin prej kartoni, tabelën e tij të turpit. E shihja me një ngazëllim total ndërsa po ecte tutje, me një hap të çlirët dhe me kokën akoma lart. Ndoshta nuk do ta marr vesh kurrë fundin e historisë së tij, por e di me siguri që Zoti filloi një punë të madhe te Badi atë ditë, dhe Ai i çon gjithmonë deri në fund punët e tij. Aleluja!



Shpresë dhe shërim

për çrregullimet e të ngrënimit

A ka një pikë ku dieta bëhet vdekjeprurëse? A mundet që dëshira për t'u dukur e dobët dhe "në formë" të bëhet një fiksim i pashëndetshëm? A është e mundur që sjellja e një gruaje të kontrollohet nga frika e shtimit në peshë?

Megjithëse nuk duhet të habitemi që përgjigjja për këto pyetje është "po", gjëja alarmuese është se çrregullime në të ngrënët, si anoreksia dhe bulimia, po prekin edhe shumë gra të krishtera në botë. Nëse jemi çliruar nga fuqia e mëkatit, siç na thotë Bibla, pse ndodh që të krishterat të bëhen skllave të varësive? Gratë në kishë shpesh kanë turp të kërkojnë ndihmë dhe i fshehin mundimet e tyre përmes çrregullimeve në të ngrënë. Le të shohim, sé pari, se çfarë janë anoreksia dhe bulimia.

Anoreksia nervoze është diagnoza klinike që u jepet individëve që e shtyjnë veten në mosushqyerje (dhe shpesh ushtrohen tej mase), në përpjekje përtë mbajtur një peshë nën të shëndetshmen, që zakonisht përkufizohet si 20% më pak se mesatarja e gjatësisë së personit. Dieta ekstreme dhe frika e shtimit në peshë (bashkë me të shikuarit e vvetvetes si të shëndoshë kur në fakt je nën peshë) mund të çojë në dëmtime kardiak, cikle menstruale të ndërprera, osteoporozë të parakohshme, mosfunkcionim të veshkave, humbje të flokëve dhe probleme të tjera shëndetësore.

Bulimia nervoze përshkruan ciklin "mbingopje-zbrazje" të konsumimit të sasive të mëdha të ushqimit, pastaj nxjerrjen e tij me anë të vjelljes, laksativëve, diuretikëve dhe/ose ushtrimit

të tepruar. Shumë bulimike kanë qenë më parë anoreksike, ose i kombinojnë dy sjelljet përtë kontrolluar peshën e tyre. Pasi vështirësia e mosushqyerjes bëhet aq e madhe, sa gruaja dorëzohet, ha, përtë kënaqur oreksin (që ia ka mohuar vetes përtë kaq shumë kohë), dhe pastaj e nxjerr ushqimin, duke e bërë këtë "mjetin e saj të sigurt". Tani ajo ndihet plotësish jashtë kontrollit. Bulimiket zakonisht janë të vetëdijshe përtë rreziqet shëndetësore, ku përfshihen çekuilibrimet elektrolite (të cilat mund të çojnë në aritminë e zemrës dhe në dëmtim të veshkave), këputje të ezofagut dhe probleme me dhëmbët.

Një tjetër pasojë afatgjatë e anoreksisë dhe bulimisë është shterpësia. Përqindja mesatare e yndyrës në trupin e një gruaje është midis 14-20%. Kur kjo bie nën 8-10%, estrogjeni nuk prodhohet më në sasi të mjaftueshme dhe ovulacioni ndalon. Shpesh, steriliteti dhe abortet spontane janë rezultat i çrregullimeve të të ngrënimit. Ky është një çmim i lartë përtë pagur vetëm përtë qenë e dobët!

Çfarë i shkakton çrregullimet në të ngrënë?

Edhe pse shpesh fajësohet media përtë barazimin e dobësisë me bukurinë, e vërteta është se GRATË E ÇDO EPOKE

Nga Marie Notcheva

kanë dashur të konsiderohen tërheqëse dhe të dëshirueshme. Shqetësimin përtë pasur cilësi "të përsosura" fizike Bibla e quan *grenari*.

Dhe ne gratë jemi famëkeqe përtë krashtasim e vetes me të tjerat! Ndërkohë që disa fajësojnë reklamat moderne përtë mesazhin që u dërgojnë grave, psikologët i etiketojnë këtë çrregullime si "sëmundje mendore" dhe shumë njerëz i konsiderojnë ato si sëmundje. Megjithatë, kjo është e gabuar; nuk ka *asnjë* shkak organik ose gjenetik përtë anoreksinë dhe buliminë. Nuk mund t'i ia vëmë fajin vetëm medias ose biologjisë. Çrregullimet në të ngrënë vijnë si rezultat i dëshirave idhujtare dhe zemrës së mashtruar nga mëkatë (Jeremia 17:9). Ato janë *sjellje të mësuarë*, të cilat, me hirin e Perëndisë, mund të *çmësohen*.

Çdo veprim dhe vendim që marrim paraprihet nga një mendim. Pastaj një mendim tjetër, dhe një tjetër pas tij. "Unë jam e shëmtuar. Duhet të bie në peshë." Me kalimin e kohës, këtë mendime bëhen meditim. Meditimi herët a vonë çon në një veprim. "Hëngra t-për... Do ta nxjerr." Shumë shpesh gruaja në këtë fazë nuk e kpton sa serioze është në të vërtetë kjo gjë dhe se së shpejti do të gjendet në kurth. Veprimi përsëritet dhe kështu formohet zakoni. "Kjo ka shumë kalori... Nuk mund ta ha po nuk bëra një orë vrap." Kështu kalojnë javë, muaj dhe robëria rrënjoset thellë.

Përtë grua që lufton me anoreksinë dhe buliminë, pesha është bërë *idhulli* i saj. "Idhull" është çdo gjë që e dëshirojmë aq shumë, sa jemi të gatshëm

të mëkatojmë për ta përfituar atë, është një dëshirë e tipit “do të bëja gjithçka për të; do të jem e lumtur vetëm kur ta kem”. Si anoreksia, ashtu edhe bulimia janë mënyra vëtëshkatërruese për të arritur një qëllim idhujtar: të qenët më e dobët me çdo kusht. Kur kjo mendësi kontrollon një bijë të Perëndisë, ajo duhet të kujtojë pozicionin e saj në Krishtin. Besimtarja, mendja e së cilës është “në gjërat që janë atje lart” (Kolosianëve 3:2), është e fokusuar në gjërat që kanë vlerë të përjetshme dhe nuk do të bjerë pre e mendimeve jobiblike, që nxisin çrregullimet në të ngrënë. Megjithatë, i krishteri duhet të marrë shpresë kur kupton se Jezus Krishti vdiq edhe përkëtë mëkat.

Fjala e Perëndisë dhe çrregullimet në të ngrënë

Kur isha fëmijë, më pëlqente shumë historia e “Rosakut të shëmtuar” nga Hans Kristian Andersen. Ëndërroja të shndërrohesha në një mjellmë siç ndodh në fund me rosakun e shëmtuar dhe të pranohesha në nivelet e të bukurave. Në fund të shkollës së mesme, ende nuk isha shndërruar në mjellmë. Me 39 kilogramë peshë dhe në prag të vdekjes, unë isha një adoleshente në nevojë të dëshpëruar për Krishtin. Ajo që kishte nevojë për shndërrim ishte zemra ime. Apostulli Pal na thotë te Romakëve 12:2: “Dhe mos u konformoni me këtë botë, por transformohuni me anë të ripërtëritjes së mendjes suaj.” Kjo do të thotë se nuk duhet të kopojmë sjelljet, mendësitë ose përparësitë e kësaj bote (përfshirë këtu edhe vlerësimin e dobësisë dhe pamjes fizike mbi marrëdhëni tonë me Krishtin). Ne “ripërtërijmë mendjen tonë” (mësojmë të mendojmë mendimet e Perëndisë dhe të ndajmë përparësitë e Tij) teksha meditojmë mbi Fjalën e Tij.

Perëndia na ka dhënë gjithçka që na nevojitet për t'i përporthur mendimet tonë me vullnetin e Tij dhe për të bërë një jetë të fuqizuar nga Fryma e Shenjtë (2 Pjetrit 1:3). Si duhet të shfaqet kjo në jetën e një gruaje, e cila dëshiron të braktisë anoreksinë ose buliminë? Së pari, ajo duhet të kuptojë të vërtetën e pozicionit të saj në Krishtin: **ajo nuk është më skllave e mëkatit.** Tek 1 Korintasve 6, Pali u kujton besimtarët se ata ishin ndryshuar plotësisht! Sjellja mëkatare

ishte lënë në të shkuarën. E njëjtë gjë është e vërtetë për një të krishterë me çrregullime në të ngrënë. Edhe pse ndonjëherë dëshira dhe nxitja mund të duken shumë të fuqishme, ajo mund të zgjedhë ta tejkalojë përgjithmonë fiksimin e saj për ushqimin dhe peshën.

A vuan nga anoreksia ose bulimia, por dëshiron të jesh e lirë? Shpëtimtari që pastroi lebrosët dëshiron të shërojë edhe zemrën tende. Ja disa pikë kyçë për të ecur në fitore, me ndihmën e Tij:

- Pendoju.** Prano vullnetin e Perëndisë se sjellja me çrregullime në të ngrënë është e gabuar dhe përkushtohu për t'u larguar prej saj.
- Pranoje hirin e Perëndisë çdo ditë.** Pavarësish sa herë biem, hiri i Perëndisë nuk shteron kurrë. Gratë me çrregullime në të ngrënë janë përgjithësisht perfeksioniste. Kjo mendësi me synim performancën bie në kundërshtim me ungjillin, i cili kërkon që ne ta përulum veten si

fëmijë (Mateu 18:4). Beso se falja e Tij është më e madhe se mëkatit yt.

- Ripërtëri mendjen tende.** Lutu dhe lexo Biblën çdo ditë, për të zhvilluar një mënyrë të perëndishme të menduari për ushqimin, pamjen dhe bukurinë e vërtetë.
- Nënshtro çdo mendim për ta bërë të bindur ndaj Krishtit** (2 Korintasve 10:5). Sa herë që tundohesh të mbingopesh ose ta nxjerrësh ushqimin, të krahasosh veten me një modele në kopertinën e një reviste, ose të ofendohesh nga një koment, etj., ndalo dhe rivendosi mendimet e tua në dritën e mësimeve të Krishtit.
- “Zhvish”** sjelljet dhe mendimet e vjetra të çrregullimeve në të ngrënë. **“Vish”** sjelljen që nderon Perëndinë (Efesianëve 4:22-24).

Një e krishterë anoreksike ose bulimike duhet të refuzojë me ndërgjegje gjenjeshtrat që ka përvetësuar dhe t'i zëvendësojë ato me të vërtetën e ungjillit. Për shembull:

ZHVISH	VISH
Numri në peshore përcakton vlerën time	Unë jam krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë (Zan. 1:26) dhe qëllimi im është ta përlëvdoj Atë (Ps. 86:9, Isa. 60:21)
Numërimi i kalorive	Ushqimi është i rëndësishëm për të jetuar; merre me falënderim (1 Tim. 4:4)
Frika nga shtimi në peshë	Perëndia e ka krijuar trupin tim; unë mund t'i besoj Atij teksta ha në mënyrën e caktuar prej Tij. (Psalmi 139:13)
Disa ushqime janë të ndaluara ose “të pista”	Asnjë ushqim i veçantë nuk është i papastër (Veprat 10:15)
Nuk i interesoj askujt, bëj mirë ta ngushëlloj veten duke u mbingopur.	Perëndia më do dhe unë mund të kthehem tek Ai (1 Pjetrit 5:7)

- Së fundmi, adhurimi dhe bashkësia e rregullt janë shumë të rëndësishme. Mos ki frikë t'ia tregosh mundimin tënd një mikeje tjetër të krishterë, që mund të të këshillojë, të të inkurajojë e të lutet me ty. Perëndia që na shfajëson nga mëkatit është ende

besnik ta shndërrojë jetën e bijave të Tij. Në Krishtin ka liri të vërtetë dhe të qëndrueshme nga varësitë. Anoreksia dhe bulimia janë robëria që mund të lihen te këmbët e Kryqit përgjithmonë!

Marie Notcheva është një autore dhe folëse e krishterë nga Massachusetts, SHBA. Si këshilluese biblike e certifikuar, ajo është kontribuuese e rregullt e blogut të Koalicionit të Këshillimit Biblik (The Biblical Counselling Coalition). Në vitin 2011, Calvary Press botoi librin e saj “E çliruar nga humnera: pendimi biblik dhe restaurimi nga robëria e çrregullimeve në të ngrënë.” Ajo ka vizituuar dy herë Shqipërinë dhe e do shumë këtë vend. Ajo dhe bashkëshorti i saj, Ivaylo, kanë 4 fëmijë.

DIKUSH

më do ashtu siç jam

Jam Lule Potera, jam nga Kosova. Si fëmijë kam pasur një natyrë shumë kureshtare. Kisha dëgjuar të flitej në shtëpi për Zotin vetëm kur i ndodhët diçka dikujt, për mirë ose për keq. Atëherë përmendej emri i Tij. Në shkollë mësuesit na thoshin se historikisht kishim qenë të krishterë, por që sundimi otoman turk e kishte kthyer popullin tonë në myslimanizëm. Gjithmonë mërzitesha kur të afërmit e mi me krenari flisin keq për të krishterët, e unë nuk mund ta kuptoja pse duhet të turpëroshim për besimin e të parëve tanë... A ishte kjo në shërbim të kombit tonë? Tashmë nuk dyshoja në ekzistencën e Perëndisë, por nuk më mjaftonte ta dija vetëm se Ai ekzistonte. Shumë ma interpretasin Perëndinë si Dikush të Cilit duhet t'ia kemi frikën, por kjo para meje i jepte Atij një pamje të urryer dhe jo të dashur. Brenda meje diçka më thoshte se Perëndia na do, por prapë nuk e dija si-në dhe pse-në. Shpesh pyesja veten: po kur themi se Perëndia na do, a ka të bëjë kjo vetëm se na ka bërë njerëz dhe jo kafshë?

Në pranverën e vitit 2002 isha në përfundim të shkollës së mesme të mjkësisë. Isha shumë në tension kur

mendoja rreth regjistrimit në universitet. Meqë isha njëra ndër nxënëset me rezultate të mira në mësime, të gjitha shoqet më donin, por e dija që ishte për interes. Edhe pse më shihnin si vajzë fatlume, unë ndihesha shumë e palumtur dhe e zbrazët. Gjithë lëvdatat e mësimdhënësve dhe shoqeve në shkollë s'ë mbushnin dot zbrazëtinë brenda meje. Ishte kjo koha kur i bëja shumë pyetje vetes: Cili është kuptimi i jetës? Bëja pyetje përtëj njohjes sime..., e shpesh e kërkoja edhe Zotin, por më dukej shumë i largët. Sa më shumë që vazhdoja me pyetjet, jeta më dukej aq më e pakuptimtë. Çdo gjë më dukej e zyrtë. Gjëja që më së pakti pëlqeja tek vetja ishte ajo që i falja dhe i duroja lehtë njerëzit kur më bënин padrejtësi dhe këtë e konsideroja dobësi.

Më kujtohet që rrugës për në shkollë u hap një dyqan me veshmbathje nga Amerika dhe meqë çmimet ishin të lira dhe cilësia e tyre ishte e mirë, më pëlqente ta vizitoja shpesh. Një ditë, posa hyra aty me disa shoqe, vëmendjen ma tërhoqën disa libra që qëndronin në një raft. Me nxitim shkova t'u hedh një sy dhe pyeta shitësen nëse mund t'i marr. U gëzova kur mora përgjigjen

pozitive. Në dorë tani kisha Dhiatën e Re, Ungjillin sipas Gjonit dhe disa libra e broshura të tjera të krishtera. Posa shkova në shtëpi, fillova, së pari, me leximin e Dhiatës së Re.

Librin e kam pasur mikun më të mirë në jetë, por ky libër tani më dha një ndjesi krejt ndryshe nga librat që kisha lexuar më parë. Por kishte edhe gjëra të shumta që s'i kuptoja fare, si p.sh. kur flitej për Perëndinë, nganjëherë thuhej Ati, herë Biri e herë Shpirti/Fryma e Shenjtë, si dhe përmendeshin terminologji të ndryshme biblike, që s'ua dija domethënien. Sidoqoftë, ky libër tani më ndihmoi t'i shoh gjërat ndryshe dhe mësimet ishin krejt ndryshe nga ato që kisha marrë gjatë gjithë jetës sime. Nga aty e kuptova se, të jesh në shërbim të të tjerëve dhe të falësh lehtë të tjerët, nuk ishte dobësi: në sytë e Perëndisë është virtut. Më vinte shumë keq për veten për vitet që i kisha jetuar në gënjeshtë, duke menduar që isha mjaft e mirë.

Atë vit nuk u pranova në universitet, si pasojë edhe pesimizmi im për jetën u shtua. Kur lexoja këtë libër, ata të familjes shpesh më kritikonin, duke më thënë se po humbisja kohën duke lexuar libra fetarë, në vend që të



përgatitesha për testin kalues për në universitet.

Doja shumë të vizitoja një kishë katolike, sepse në atë kohë së dija që ka dallime mes kishës ungjillore dhe asaj katolike. Për ta vizituar, më duhej të shkoja në Prishtinë dhe s'njihja njeri atje.

Në vitin 2005 fillova të punoj si infermieri në një klinikë në qytetin tim. Atë vit u regjistrova edhe në universitet. Ngjitur me punën time u hap një qendër ku disa amerikanë po jepnin mësimë të gjuhës angleze. Në atë kohë motra ime më e vogël ishte e interesuar të vijonte një kurs për gjuhë të huaj. E inkurajova që të aplikonte aty. Ajo u pranua. Me qëllim që ta mësonte gjuhën më mirë, ajo filloi të lexonte literaturë angleze dhe gjeti Jezusin në disa nga librat e C.S.Lewis-it. Kur motra pranoi Jezusin si Zot dhe Shpëtimtar të saj në gushtin e 2006-ës, nuk më tregoi. Ajo kishte frikë se do ta trajtoja në të njëjtën mënyrë si ajo më kishte trajtuar mua kur kisha lexuar Biblën para katër vitesh. Dhe në fakt e bëra, në momentin kur e mora vesh.

Një ditë motra më ftoi të shkoja me të për të vizituar familjen e pastorit të

saj. U ndjeva shumë mirë nga shoqëria me ta dhe më bënë të ndihem një njeri me shumë vlerë. Pas një javë nga kjo vizitë, vizitova kishën e saj. Më preku shumë thjeshtësia dhe dashuria e pa interes e njerëzve në kishë. Bota reklamon se çelësi i lumturisë është paraja, por unë pashë që asnjeri aty s'dukej se ishte i pasur, por të gjithë dukeshin shumë të lumtur dhe rrezatonin një gjëzim të madh. Kur filluan të luten, thashë me vete: "Ja, këtë kam dashur gjithë jetën, të dëgjoj të luten, në gjuhën time". Pastaj kur i kenduan Zotit, po të mos më vinte turp nga njerëzit, do të qaja me zë. Brenda meje e pranova Jezusin, por thosha se po t'i trejoja njerëzve, do të më merrnin përmendjelehtë.

Frika ime e vetme ishte që po ta shpallja se e kisha pranuar Jezusin, të gjithë shokët dhe shoqet do të më largoheshin. Më kujtohet kur pyeta gruan e pastorit: "A të ka ndodhur në jetë të humbasësh shokët/shoqet?" Kur ajo e kuptoi brengën time, më siguroi që Perëndia premton se, nëse keni humbur diçka për emrin e Tij, Ai do të na i shumëfishonte ato. Këtë e kam vërtetuar më vonë. Jo vetëm që s'humba asnjërin nga ata, por Ai më dha shumë e

më shumë shokë e shoqe nga e gjithë bota.


Më 4 tetor 2006 u pagëzova. Më dukej sikur dielli ndriçonte vetëm përmua! Ishte dita kur gjëzimi dhe shpresë mbushën zemrën time. Tani e kuptova që, për të pasur jetë, u desh që dikush të vdiste për ty dhe këtë kishte bërë Jezusi përmua.

I jam falënderuese Atij që e ka dhënë veten e Tij përmua dhe m'ka hapur sytë e mendjes dhe më ka zbutur zemrën, që të bëj zgjedhjen e duhur për jetën time, dhe ka bërë që të mos ndikohem nga traditat/ritet ose nga paragjykimet e botës.

S'ka gjëzim më të madh sesa të kuptosh se DIKUSH të do ashtu siç je, se ka vdekur për ty dhe është ringallur për ty dhe jeton për ty dhe te ti—nëse ti ia jep atë vend Atij. Ne jemi të lirë në tokë që të marrim njërin nga këto vendime: të jemi me Perëndinë në tokë për të qenë përgjithmonë me Të në qiell ose të jemi pa Perëndinë në tokë, për të qenë pa Të përgjithmonë.

Zoti ju bekoftë!

*Në shërbim të Tij,
Lule Potera*



Fotografia u dha me mirësjellje nga Yad Vashem (www.yadvashem.org)

Kori Ten Bum (Cornelia "Corrie" Johanna Arnalda ten Boom) lindi më 15 prill 1892 në Amsterdam, fëmija e katërt dhe e fundit e çiftit Kasper dhe Kor ten Bum. Familja Ten Bum ishin anëtare e Kishës së Reformuar Holandeze, e cila kishte besimin e fortë se çdo qenie njerëzore ishte e barabartë para Perëndisë. Kur Kori ishte ende fëmijë, familja u shpërngul në Harlem (Haarlem), një qytet aty pranë. Atje hapën një dyqan orësh. Dyqani gjendej në zemër të pjesës hebraike të qytetit, gjë që u jepte mundësinë familjes së Korit të njihnin shumë anëtarë të bashkësisë judease, miqësia me të cilët i lejonte të merrnin pjesë në takimet e shabatit, festat e tyre, si dhe të lexonin Dhiatën e Vjetër së bashku.

Familja Ten Bum kishte një histori të hershme lidhjesh personale me bashkësinë lokale hebraike, duke nisur nga gjyshi i Korit, i cili kishte mbështetur përpjekjet për përmirësimin e marrëdhënieve judeo-kristiane në Holandë. Babai i saj kishte bindjen e thellë se izraelitët ishin populli i zgjedhur i Perëndisë, një bindje që do ta shoqëronte fuqishëm gjatë gjithë jetës e që do të projektohej po aq fort tek fëmijët e tij. Vëllai i Korit, Vilemi, shërbente

në kishë dhe u prezantonte ungjillin hebreve. Ai drejtonte edhe një azil për të moshuarit e çdo besimi, i cili në fund të viteve 1930 do të shërbente si strehë për judenjtë e arratisur nga Gjermania.

Pas dy vjetësh studimi në mjeshtëri-në e orëndreqjes, në vitin 1922 Kori ten Bum u bë femra e parë orëndreqëse e licencuar në Holandë, duke marrë kështu drejtimin financier të biznesit të familjes. Nën drejtimin e saj, të ardhurat e siguruara nga dyqani i orëve, edhe pse jo të mëdha, do të ishin gjithnjë të bollshme për plotësimin e nevojave të familjes e për t'i lejuar ata të ndihmon edhe të tjerët. Gjatë kësaj kohe e më pas, dy ndër njerëzit më ndikues dhe frymëzues për Korin do të ishin nëna e saj, Kor (e cila vdiq në 1921 kur Kori ishte 29 vjeç), për ndjenjën e bujarisë, vetëmohimit dhe dashamirësisë, dhe motra e saj, Betsi, për shpirtin e faljes.

Pas pushtimit të Holandës nga forcat naziste gjermane, shtëpia e familjes Ten Bum do të shndërrohej në një qendër për veprimtaritë e rezistencës holandeze kundër nazistëve. Ashtu siç kishin bërë edhe para pushtimit, ata do të vazhdonin të kujdeseshin për strehimin dhe mbrojtjen e hebrenve, duke e vënë seriozisht në rrezik jetën e

tyre. Gjatë kësaj kohe, familja ndërtoi një dhomë të fshehtë brenda dhomës së Korit, dhomë që do të bëhej e famshme si "Vendi i fshehtë". Dhoma e Korit ndodhej në pjesën më të lartë të shtëpisë, gjë që u jepte më shumë kohë për t'u fshehur personave të kërkuar që gjendeshin aty në rast bastisjeje të shtëpisë nga nazistët. Ata ndërtuan një mur të rremë rreth 30 cm larg nga muri i vërtetë i dhomës dhe aty vunë një raft me një derë të rrëshqitshme në pjesën e poshtme. Nga kjo derë, njerëzit mund të kalonin këmbadoras për t'u fshehur në dhomën e fshehtë rreth 70 cm të thellë, të pajisur me një sistem ventiliimi që mundësonte frymëmarrjen, dhe të prisnin të sigurt derisa kontrolluesit të largoheshin. Rreth 800 njerëz mendohen të kenë shpëtuar prej nazistëve, duke përdorur shtëpinë e familjes Ten Bum si një vend të sigurt.

Gjithsesi, veprimtaria e familjes Ten Bum iu bë e njohur forcave të Gestapos nga një spiun holandez dhe në 28 shkurt 1944 ata kontrolluan shtëpinë. Ata ngritën një kurth dhe pritën gjatë gjithë ditës në afersi të shtëpisë dhe në mbrëmje u arrestuan 30 persona. Ndërkohë, në vendin e fshehtë ndodheshin dy burra e dy gra hebrenj, si edhe

dy anëtarë të rezistencës holandeze. Me gjithë kontrollin e imët, Gestapoja nuk arriti t'i gjente dhe ata ndenjën aty për 47 orë, derisa forcat gjermane u larguan dhe forcat e rezistencës u erdhën në ndihmë. Katër nga këta persona do t'i mbijetonin Luftës së Dytë Botërore.

Familja Ten Bum u arrestua dhe u dërgua në burgun e Sheveningenit (Scheveningen). Babai i familjes, Kasperi, ishte 84 vjeç dhe vdiq dhjetë ditë pas arrestimit. Kur një rojë e pyeti nëse e kishte ditur se po rrezikonte jetën përmbrojtjen e judenjve, ai u përgjigj: "Për mua do të ishte nder të jepja jetën përmpopullin e lashtë të Perëndisë." Kori dhe Betsi kaluan dhjetë muaj nëpër tri burgje të ndryshme, dy holandeze dhe, i fundit, kampi famëkeq i përqendrimit në Ravensbrück, pranë Berlinit në Gjermani. Ditën e dërgimit atje, Kori ten Bum ishte e vetmja që nuk u kontrollua nga rojat gjermane, gjë që i lejoi të mbante Dhiatën e Re që kishte fshehur në palën e fustanit. Gjatë kohës në kamp, edhe pse kushtet ishin të tmerrshme, Kori dhe Betsi nisën t'u dëshmonin çdo natë grave të tjera nëpër baraka dhe të drejtonin takime adhurimi dhe leximi të Biblës.

Betsi, shëndeti i së cilës kishte qenë gjithmonë i brishtë, vdiq më 16 dhjetor 1944, në moshën 59-vjeçare. Ndër fjalët e fundit që Kori do të mbante mend prej saj ishte nxitja përtakna ndarë dëshminë e saj me botën kur të ishte e lirë. "Nuk ka thellësi aq të madhe, sa Perëndia të mos e mbushë," do të ishte thënja e tyre e parapëlqyer. Kori ten Bum u lirua po atë muaj, për shkak të një gabimi të administratës gjermane. Një javë pas lirimtë saj, të gjitha gratë moshatare me të u dërguan në dhomat e gazit përtu ekzekutuar.

Kori pas lirimtës u kthye në Holandë, ku fillimisht mori me qira një shtëpi që do ta përdorte si strehë përtakna gjymtarit dhe ish-të burgosurit e kampeve të përqendrimit, punë të cilën do ta vazhdonte deri në vitin 1966. Që pas vitit 1945, kur shkroi librin e saj të parë të kujtimeve nga koha e luftës, të shkruarit do të kthehet në një mjet të rëndësishëm të shërbesës së saj. Në vitin 1971, ajo do të shkruante librin Vendi i fshehtë, i cili do të ishte vepra e saj më e suksesshme dhe një burim fryshtëzimi e nxiteje përtakna krishterët në mbarë botën, një libër



Shtëpia dhe dyqani i familjes Ten Bum në Haarlem

i përkthyer edhe në shqip. Ajo udhëtoi gjëresisht në Shtetet e Bashkuara dhe në Evropë përtakna ndarë dëshminë e saj nëpër kisha, grupe studimi Bible dhe konferenca ungjillore, duke vizituar më se 60 vendë në një periudhë prej 33 vjetësh.

Mesazhi i saj fokusohet mbi ungjillin, me një theks të veçantë mbi faljen. Kjo pikë e rëndësishme e besimit të saj do të vihej në provën në vitin 1947, kohë kur ajo udhëtoi në Gjermani përtakna treguar historinë e saj. Pas fjalimit të saj, një burrë do të vinte ta takonte. Ai burrë ishte një nga rojat e kampit të përqendrimit, ku motra e saj kishte humbur jetën. Pasi i tregoi se tashmë ishte bërë i krishterë, ai kërkoi faljen

e saj përgjigjeje me lot në sy: "Unë të fal, vëlla! Me gjithë zemër!" Edhe më pas, gjatë gjithë fjalimeve që mbante, ajo u kujtonte njerëzve se kishte parë se të vetmet viktima të trajtuara mizorisht nga nazistët që kishin qenë në gjendje ta rindërtionin jetën, ishin ata që kishin gjetur forcën përtakna falur.

Problemet me shëndetin bënë që në moshën 85-vjeçare ajo të tërhiqej ngajeta publike dhe të mos bënte më udhëtime të gjata. Në vitin 1978, ajo humbi aftesinë përtakna folur dhe mbeti invalide përshtakna të një hemorragji cerebrale. Kori Ten Bum vdiq më 15 prill të vitit 1983, në ditëlindjen e saj të 91-të, në Kaliforni. Ajo nuk ishte martuar kurrë.

Kori Ten Bum ka marrë nderime të shumta kudo në botë përvetësuar e saj në shërbim të njerëzimit. Ajo u nderua nga shteti i Izraelit përtakna punën e saj në ndihmë të hebrenjve, ndërsa e ftuan të mbillte një pemë në bulevardin e Të drejtëve midis kombeve, në luginën e Yad Vashem-it në Jerusalem. Shtëpia e saj e fëmijërisë, ku ndodhet "vendi i fshehtë", është kthyer në një muze kushtuar asaj dhe familjes Ten Bum.

Përgatiti Brunilda Rustani



Vendi i fshehtë në dhomën e Kori Ten Bum-it dhe rafati që shërbente si hyrje në të. Fotografia nga Kris Kandel

Engjëlli im i vogël që shkoi në qelli!

Mua më quajnë
Dorina dhe jam
një nënë dhe
bashkëshorte.

Unë kam 15 vjet
martesë me Arjanin,
bashkëshortin tim.

Unë jam një nënë
e dy djemve, Sveni
i cili është 14 vjeç
dhe Danieli, i cili
sot do të ishte 7 vjeç.

Të qenët nënë është
një privilegji shumë
i madh për mua.
Gjithashtu mëmësia
ka sjellë si gjëzime,
ashtu edhe sfida.

Lindja e Danielit ishte një nga gjëzimet dhe bekimet shumë të mëdha në familjen time. Kur ai ishte dy vjeç, doktorët e diagnostikuan Danielin me një sëmundje shumë të rrallë gjenetike dhe kjo sëmundje nuk kishte trajtim mjekësor. Çdo ditë unë e çoja Danielin në një terapi zhvillimi dhe e çoja edhe në kopsht në mënyrë që ai të krijonte miqësi me fëmijët e tjerë. Në shumicën e rasteve Danieli kishte shumë dhimbje në trupin e tij, por edhe pse vuante, ai buzëqeshte dhe na puthte dhe përqafonte tërë kohën. Edhe pse sëmundja e Danielit ishte e vështirë për ta trajtuar, kjo kohë na bashkoi më shumë së bashku me bashkëshortin dhe familjen time. Dhe të gjithë u vumë në dispozicion se si ta ndihmonim djalin tonë pa pyetur përkohën apo edhe kostot e trajtimit.

Para tre vjetësh dëgjova rrreth MOPS (*Mamatë me fëmijë parashkollorë*) nga një mikeshë imja. Kur hyra për herë të parë në takimin e MOPS unë nuk njihja asnjë person, por sa hyra në dyert e asaj dhome ku ishte takimi i MOPS, m'u afroan shumë nëna dhe pata ndjesinë sikur këto nëna i kisha takuar prej kohësh. Unë fillova të shkoja rregullisht dhe në çdo takim ne njiheshim më mirë dhe gjithnjë e më shumë ndanin përvojat tona dhe jam ndier shumë mirë, sepse ishte një periudhë e vështirë që isha shkëputur nga njerëzit për arsyet shëndetësore të djalit tim, Danielit. Ngrohtësia dhe dashuria që mamatë më falnin në MOPS më bënë që të inkurajohesha shumë. Ato asnjëherë nuk e gjykonin djalin tim, por gjithmonë më jepnin kurajë përkohës sëmundjen e djalit tim.



Në datën 17 prill të vitit 2016 mua më ndodhi fatkeqësia më e madhe që mund t'i ndodhë një nënë. Djali im i vogël, Danieli, u largua nga kjo botë. Danieli bëri një aksident dhe jetë e tij mbaroi shumë shpejt. Vetëm zemra e një nënë e di se ç'do të thotë të humbësh një fëmijë. Një ndër personat e parë që mora në telefon pas aksidentit ishte një nga drejtueset e MOPS Tirana, sepse në ato momente të vështira e dija që mikeshat e mia do të gjendeshin aty përmes. Humbjen e djalit nuk mund të ma zëvendësojë asgjë dhe askush, por në ato momente gjeta shumë mbështetje te këto mama të mrekullueshme që më ngritën në këmbë përsëri dhe nuk më lanë vetëm, por ishin gjithmonë aty me mua. Në fakt një Fjalë e Urtë nga Bibla thotë: "Një fjalë e thënë në kohën e duhur është si mollët e arta në një pjatë argjendi". Ky komunitet nënash më është gjendur afër çdo moment dhe unë kam nevojë përmes ato. Ju dua shumë mama të MOPS!

Nga Dorina Sokoli



Duke u mbështetur te Zoti



Quhem Mehreme Mazreku, për shkurt Ema. Kam lindur në korrik të vitit 1994, në Malishevë, një qytezë e vogël në Kosovë. Unë jetoj bashkë me familjen time e cila tashmë përbëhet nga 5 anëtarë: nëna, dy motrat, vëllai dhe unë. Babai ynë vdiq në vitin 2003 nga infekzionet e shumta dhe të pashërueshme të shkaktuara nga plagosja me granatë gjatë luftës në Kosovë. Për dy vite rresht pas mbarimit të luftës, babai im, megjithëse me plagë lufte, dukej sikur gëzonte shëndet të plotë, derisa sëmuret sërisht dhe ndahet ngajeta në 2003, ngaqë në vendin tonë plagët e tij ishin të patrajtueshme.

Mbas vdekjes së babait, jeta filloj të bëhej tepër e vështirë, sidomos për nënën tonë që duhej të kujdesej për katër fëmijë të vegjël. Shtëpia jonë ishte shkatërruar gjatë luftës dhe ato pak prona që na i la babai në trashëgimi u përvetësuan nga xhaxhai ynë që kishte 8 fëmijë të rritur, madje të martuar. Xhaxhai që uzurpoi dhe shfrytëzoi gjithë pasurinë që na kishte lënë babai, e përzuri nënën tonë duke na lënë të gjithëve bashkë pa kurrgjë. Nëna ishte e vetme në përkujdesjen e saj ndaj nesh.

Në këtë kohë motra ime më e madhe dëgjoi që në Malishevë, mes një popullsie kryesisht myslimanë, kishin ardhur disa të krishterë me të cilët filloj të shoqërohej. Ajo shkonte në takimet e fëmijëve dhe një herë ftoi edhe motrën e dytë që të shkonte me të. Motra e dytë që kishte shumë dëshirë të bëhej myslimanë e devotshme refuzoi, pavarësisht këmbënguljes së motrës së madhe.

Ishte kohë Krishtlindjeje. Motra e madhe nuk kishte hequr dorë nga

kërkesa ndaj motrës së dytë që të vinte në takimet e fëmijëve. Në ato takime u shpërndanë dhurata për çdo fëmijë që shkonte atje. Dhuratat vinin nga Operacioni 'Fëmija i Krishtlindjes' dhe ime motër sjell në shtëpi një dhuratë për secilën nga ne motrat. Dhuratat u bënë tërheqja e parë që më në fund motra ime të fillonte të shkonte në takimet e fëmijëve. Duke qenë në takim, motra e dytë dëgjoi ungjillin dhe pasi u bë besimtare vetë, filloj të më ftonte mua dhe tim vëlla që të shkonim bashkë me të. Disa vite më vonë edhe nëna fillon të vijë në kishë dhe e gjithë familja shpëtohet.

Arsyeja e parë që më shtynte të shkoja në kishë ishte shoqëria dhe dashuria e udhëheqësve në kishë, veçanërisht pastori Randy Harvey, i cili ishte si baba përmua dhe familjen time. Meqë isha në moshë shumë të re, që nga ajo kohë jam rritur duke dëgjuar histori nga Bibla dhe kam besuar në Zotin, por në moshën 13 vjeçare në jetën time ndodhi një ndryshim total në mendimet e mia se kush është Perëndia. Kuptova që Perëndia është i drejtë dhe gjithashtu gjykatës i drejtë, që e dënon mëkatin dhe mëkatarin e papenduar; se Perëndia është dritë dhe në Të nuk ka kurrfarë errësirë (1 Gjonit 1:5). Kuptova që duhet një pagë përmëkatin tim patjetër dhe që kam nevojë të pendohem që Perëndia të bëjë punën e Tij në jetën time dhe të besoj që Jezusi është e vëtmja rrugë për shpëtim. Sikurse tregohet te Letra e parë e Gjonit 5:11-12, ai që ka Birin, ka jetën; ai që nuk ka Birin e Perëndisë, nuk ka jetën. Kuptova që nuk ka rrugë të mesme dhe asnjë rrugë tjetër përvëç Jezusit; Ai është sakrifica e vetme që ndreq rrugën dhe është Shpengimtar mes meje dhe Perëndisë.

Në verën e vitit 2013 u pagëzova dhe vendosa t'i bindem dhe t'a dorëzoj jetën time Krishtit dhe vazhdoj me ndihmën e Tij të bëj atë që më ka thirrur të bëj, duke qenë pjesëtare e trupit të

Krishtit, kishës.

Kam shërbyer në takimin e fëmijëve dhe në takimin e grave dhe ndërsa shërbeja në këto shërbesa unë u rrita edhe vetë në njohjen e Perëndisë dhe mësova se së pari, unë personalisht duhet të rritem në Fjalën e Zotit e pastaj të jem në gjendje të mësoj të tjerët.

Në vitin 2013 kur përfundova shkollën e mesme, u largova nga Malisheva për të studuar në universitetin e Prishtinës në Fakultetin Juridik ku mbarova 2 vite dhe e ndjeva thirrjen nga Perëndia që të ndërprisja fakultetin dhe të shkoja në shkollë biblike që përmua u bë gjëja kryesore në mendjen që të mblidhja përvete thesare në qill (Mateu 6:20) duke iu përkushtuar njohjes së Perëndisë më tepër.

Shkolla biblike kur zgjodha të shkoj është Udhëkryqi në Ersekë, ku jo rastësish jam këtu, sepse duke parë ndryshimin në jetët dhe në rritjen në Fjalën e Perëndisë te dy motrat e mia që kishin qenë aty, vendosa që këtë vit të shkollës 2016-2017 të jem studente dhe brezi i tretë i familjes këtu në Udhëkryq. Shpresoj që vëllai im të vijë vitin tjetër.

Gjatë semestrit të parë të shkollës kam qenë shumë e bekuar sepse kam njohur motra dhe vëllezër në Krishtin nga kultura dhe gjuhë të ndryshme. Ndjej gjëzim dhe paqe që jam e rrëthuar nga njerëz që me të vërtetë e duan fort Zotin, si nga stafi që e udhëheq shkollën, ashtu edhe studentët. Ndihem e privilegjuar të jem motër në Krishtin e çdo studenti këtu. Gjëja më kryesore është studimi i Biblës në thellësi që të rritem vetë personalisht në njohuri për të qenë gati kur të dal nga shkolla që Zoti të më përdorë si vegël përmbrëtërinë e Tij, që të jem dritë përvjetor qytetarët dhe vendin tim, Kosovën.

Gjatë kohës në shkollë jam bindur në zemrën time që të kem besim te Zoti me gjithë zemër dhe të mos mbështetem në mençurinë time; ta pranoj Atë në të gjitha rrugët e mia dhe të lejoj që Ai të drejtojë plotësisht shtigjet dhe planet e mia (Fjalët e Urta 3:5-6).




Të pranoja Jezusin si Zotin dhe Shpëtimtarin tim ishte dhe është vendimi më i mirë që kam marrë në gjithë jetën time. Jezusi e mbushi boshillëkun brenda meje. Ai nuk është një Zot i largët, por një Mik i vërtetë që më është gjendur pranë më ditë me diell e në ditë të errëta. Shumë gjëra kanë ndryshuar në jetën time. Unë vetë jam një njeri më i mirë, dhe jo sepse ia dola me forcat e mia, por sepse mund të bëj çdo gjë me anë të Krishtit që më forcon. Nuk them as që nuk kam më probleme, por kam një sup të fuqishëm ku mbështetem në ditët e stuhisë dhe asgjë s'mundet të më rrëzojë. Kam mësuar që mes çdo dhimbjeje të gjëj të fshehur një thesar. Lavdia i takon vetëm Perëndisë!

Nga Ejona Mema



Nuk ke pse të jetosh pa shpresë

A e ke pyetur veten ndonjëherë se çfarë ndodh pas kësaj jete? Po mendimi për vdekjen, a të sjell frikë dhe dëshpërim, apo të sjell shpresë? Të shkruara mbi dy mijë vjet më parë, Ungjilli sipas Gjonit dhe Letra e Romakëve japid shpjegime të qarta dhe të vërteta për jetën tënde dhe u përgjigjen pyetjeve si:



- Kush është Perëndia dhe si u krijua bota?
- Kush është në të vërtetë Jezus Krishti?
- A mos është historia e tij një mashtrim?
- Cila është e vërteta më e rëndësishme që ka ekzistuar ndonjëherë që duhet ta dimë?
- A ka jetë pas vdekjes?
- Pse ndodhem këtu?
- Cili është qëllimi i jetës sime?
- Ç'do ndodhë me mua kur të vdes?

Këto pyetje dhe shumë të tjera marrin përgjigje të qarta në këto dy libra të shkruar nga njerëz të frysëzuar nga Perëndia! Nuk ke pse ta pëershkosh rrugën e jetës me pyetje pa përgjigje. Nuk ke pse të jetosh pa shpresë! Jeta jote mund të transformohet tanë e përgjithmonë!

Si të rilindësh përsëri

Së pari, kupto që ne jemi të gjithë mëkatari, Bibla na thotë: "Nuk ka asnje të drejtë, as edhe një" (Romakëve

3:10). Ne të gjithë kemi shkelur Ligjin e Perëndisë dhe nuk meritojmë veçse gjykimin dhe zemërimin e Perëndisë.

Së dyti, kupto që Perëndia të do dhe Ai dërgoi Birin e Tij që të vdiste për ty. Ne të gjithë meritojmë të vdesim për mëkatet tona, por Krishti vdiq në vendin tonë: "Sepse edhe Krishti ka vuajtur një herë për mëkatet, i drejti për të padrejtët, përtëna qurante Perëndia" (I Pjetrit 3:18).

Së terti, pendohu për mëkatet e tua. Pendimi ka brenda vullnetin për t'i kthyer shpinën mëkatit dhe për t'ia dhënë jetën Jezu Krishtit, si Zoti i jetës sate: "Zoti nuk vonon plotësimin e premtimit të Tij, siç mendojnë disa sítë ishte vonesë; por është zemërgjerë ndaj nesh, sepse nuk do që ndokush të humbasë, por që të gjithë të vijnë në pendim" (2 Pjetrit 3:9).

Së katërti, eja me besim dhe beso në Krishtin. Bibla na thotë që shpëtimi është dhuratë që jepet falas, por ne duhet të përgjigjemi ndaj saj dhe ta bëjmë dhuratën tonën: "Sepse paga

e mëkatit është vdekja, por dhurata e Perëndisë ështëjeta e përjetshme nëpërmjet Krishtit Jezus, Zotit tonë" (Romakëve 6:23).

Si e pranojmë këtë dhuratë? Me një akt të thjeshtë besimi nëpërmjet të cilës i thua, "Po!" Krishtit. Nëse nuk e ke pranuar ndonjëherë më parë Krishtin në jetën tënde, të ftojmë ta bësh këtë pikërisht tanë, pa kaluar minutat. Thjesht thuaji Perëndisë se ti e di që je mëkatare dhe kërkon falje për mëkatet e tua. Thuaji që beson se Jezus Krishti vdiq për ty dhe që ti do t'ia japësh jetën tënde Atij tanë dhe ta ndjekësh Atë si Zot gjithë jetën tënde.

Nëse e ke bërë këtë atëherë Perëndia t'i ka falur të gjitha mëkatet dhe tanë t'i mund të pranosh me besim që je një kriesë e re në Krishtin: "Prandaj nëse dikush është në Krishtin, është një kriesë e re; të vjetrat shkuant; ja, të gjitha u bënë të reja" (2 Korintasve 5:17).

Dhe ne e quajtëm atë Maria..

Lajmi ishte i
papritur për ne

Disa muaj më parë kishim hequr dorë nga shpresa për të pasur një fëmijë të dytë dhe kishim filluar të dhuronim shumicën e sendeve dhe të rrobave për të sapolindur. Por kur mjeku tha që unë isha shtatzënë, unë dhe Mandi, bashkëshorti im, ngelëm të shtangur. Në fakt ngelëm edhe më të shtangur kur mjeku filloj të na 'qortonte' rëndë, duke na quajtur të pakujdeshëm, sepse shëndeti im ishte delikat dhe një shtatzëni nuk ishte ide e mirë. Në atë moment ne nuk u shqetësuam për këtë pjesë, megjithëse më vonë e kuptuam shqetësimin e tij. Zoti po na jepte një dhuratë të papritur dhe ne po shijonim lajmin e ri me sa mundnim.

Disa javë më pas erdhi surpriza e dytë. Ne ishim 'gati' për të mirëpritur fëmijën tonë të dytë. Kishim disa nga rrobat blu të Samuelit, djalit tonë, disa lodra blu, bataniye blu... ne kishim 'eksperience' me djemtë.... Gati!

Mjeku na tha që prisnim një vajzë. Po tani? Më kujtohet momenti kur dolëm jashtë zyrës së mjekut dhe rrnim të hutuar dhe të frikësuar nga ideja që Zoti po dorëzonte një lule kaq delikate në duart tona të papërgatitura. Dhe ende nuk e dinim se çfarë na priste përparrë! Ende nuk e dinim që kjo lule delikate do të ishte një mrekulli nga Zoti dhe në të njëjtën kohë një pjesë e periudhës më sfiduese të jetës sonë.

Muajt e parë të shtatzëi kaluar përbukuri. Zoti, përmotrave të mia të besimit rastafin e Institutit "Jeta e Re" siguroi pjesën më të madhe të rrobave dhe sendeve që na nevojiteshin për të mirëpritur bukuroshen tonë të vogël.

Dhe ja ku erdhi edhe muaji i gjashtë. Një mëngjes, teksha vrapoja për në zyrë, ndjeva një dhimbje të papritur afër mëlcisë. "Shtazania!", - mendova. Por jo, nuk ishte shtazenia! Pas orësh të gjata me dhimbje të padurueshme, shkova në urgjencë, ku Zoti kishte siguruar tashmë mjekun kirurg, dr. Myzaferin, i cili do të kujdesej për mua disa muaj më vonë.

Përsëri një surprizë, por këtë radhë e shoqëruar me lot e dhimbje. Mjeku tha që për shkak të një infekzioni të rëndë dhe gurëve, duhej të operohesha për të hequr témthin dhe kjo do të thoshte që lulja jonë e bukur tashmë gjashtë muajshe, për të cilën kishim thurur kaq shumë ëndrra, kishim imagjinuar jetën tonë me të, i kishim zgjedhur emrin, i kishim përgatitur 'pajën' rozë, nuk do të jetonte për ta parë dritën e kësaj bote. E pabesueshme!!!

Na duhej një mrekulli për t'i shpëtuar operacionit. E dëshpëruar, ndërsa isha nën terapi intensive në klinikën "Ikeda", i shkrova Nikki Doçit, motrës sime në besim dhe i kërkova ndihmë përmes lutjes dhe ajo ngriti urgjent një zinxhir lutjeje me motrat e tjera të



personelit të Institutit (besoj edhe shumë besimtarëve të tjera).

Një tjetër nga motrat e mia, Rudina Bakalli, kërkoi lutje nga shumë gratë krishtera nëpër botë. (Ju jemi mirënjoyhëse Nikki dhe Rudina!) Pas 24 orësh në klinikë, mjeku vjen dhe i habitur më thotë që analizat ishin normalizuar dhe për momentin nuk kishte nevojë për operacion. Ende më mbushen sytë me lot kur kujtoj atë moment. E kisha vajtuar bukuroshen time të vogël gjatë gjithë natës dhe tani po më thoshin që ajo do të jetonte. E lavdërova (dhe akoma e lavdëroj) Zotin me gjithë zemrën time që nuk lejoi të bëhej operacioni.

Por nuk mbaroi me kaq!

Mjeku gjinekolog që kujdesej për ne, hoqi dorë. Asnjë mjek tjetër gjinekolog nuk pranoi të na merrte përsipër si rast dhe ne ngelëm në mes të rrugës të pashpresë. Sytë i kishim vetëm te Zoti duke pritur për një mrekulli. Ai që na kishte sjellë deri në këtë pikë, nuk do të na braktiste, ashtu siç ka premtuar: "Sepse vetë

Dhe ne e quajtëm atë Maria.

Lajmi ishte i papritur për ne

Disa muaj më parë kishim hequr dorë nga shpresat përfshirë të pasur një fëmijë të dytë dhe kishim filluar të dhuronim shumicën e sendeve dhe të rrobave përfshirë sapolindur. Por kur mjeku tha që unë isha shtatzënë, unë dhe Mandi, bashkëshorti im, ngelëm të shtangur. Në fakt ngelëm edhe më të shtangur kur mjeku filloi të na 'qortonte' rëndë, duke na quajtur të pakujdeshëm, sepse shëndeti im ishte delikat dhe një shtatzëni nuk ishte ide e mirë. Në atë moment ne nuk u shqetësuam përfshirë pjesë, megjithëse më vonë e kuptuam shqetësimin e tij. Zoti po na jepte një dhuratë të papritur dhe ne po shijonim lajmin e ri me sa mundrim.

Disa javë më pas erdhë surpriza e dytë. Ne ishim 'gati' përfshirë mirëpritur fëmijën tonë të dytë. Kishim disa nga rrobat blu të Samuelit, djalit tonë, disa lodra blu, batanije blu... ne kishim 'ëksperience' me djemtë.... Gati!

Mjeku na tha që prisnim një vajzë. Po tani? Më kujtohet momenti kur dolëm jashtë zyrës së mjekut dhe rrnim të hutuar dhe të frikësuar nga ideja që Zoti po dorëzonte një lule kaq delicatë në duart tona të papërgatitura. Dhe ende nuk e dinim se çfarë na priste përpara! Ende nuk e dinim që kjo lule delicatë do të ishte një mrekulli nga Zoti dhe në të njëjtën kohë një pjesë e periudhës më sfiduese të jetës sonë.

Muajt e parë të shtatzëi kaluar përbukuri. Zoti, përmotratë të mia të besimit rastafin e Institutit "Jeta e Re" siguroi pjesën më të madhe të rrobave dhe sendeve që na nevojiteshin përfshirë mirëpritur bukuroshen tonë të vogël.

Dhe ja ku erdhë edhe muajt i gjashtë. Një mëngjes, teksha vropoja përfshirë zyrë, ndjeva një dhimbje të papritur afër mëlçisë. "Shtazania!", - mendova. Por jo, nuk ishte shtazenia! Pas orësh të gjata me dhimbje të padurueshme, shkova në urgjencë, ku Zoti kishte siguruar tashmë mjekun kirurg, dr. Myzaferin, i cili do të kujdesej përfshirë mua disa muaj më vonë.

Përsëri një surprizë, por këtë radhë e shoqëruar me lot e dhimbje. Mjeku tha që përfshirë shkak të një infekzioni të rëndë dhe gurëve, duhej të operohesha përfshirë hequr témhin dhe kjo do të thoshte që lulja jonë e bukur tashmë gjashtë muajshe, përfshirë cilën kishim thurur kaq shumë endrra, kishim imagjinuar jetën tonë me të, i kishim zgjedhur emrin, i kishim përgatitur 'pajën' rozë, nuk do të jetonte përfshirë parë dritën e kësaj bote. E pabesueshme!!!

Na duhej një mrekulli përfshirë shpëtuar operacionit. E dëshpëruar, ndërsa isha nën terapi intensive në klinikën "Ikeda", i shkrova Nikki Doçit, motrës sime në besim dhe i kërkova ndihmë përmes lutjes dhe ajo ngriti urgjent një zinxhir lutjeje me motrat e tjera të



personelit të Institutit (besoj edhe shumë besimtareve të tjera).

Një tjetër nga motrat e mia, Rudina Bakalli, kërkoi lutje nga shumë grata krishtera nëpër botë. (Ju jemi mirënjohezë Nikki dhe Rudina!) Pas 24 orësh në klinikë, mjeku vjen dhe i habitur më thotë që analizat ishin normalizuar dhe përfshirë momentin nuk kishte nevojë përfshirë operacion. Ende më mbushen sytë me lot kur kujtoj atë moment. E kisha vajtuar bukuroshen time të vogël gjatë gjithë natës dhe tani po më thoshin që ajo do të jetonte. E lavdërova (dhe akoma e lavdëroj) Zotin me gjithë zemrën time që nuk lejoi të bëhej operacioni.

Por nuk mbaroi me kaq!

Mjeku gjinekolog që kujdesej përfshirë, hoqi dorë. Asnjë mjek tjetër gjinekolog nuk pranoi të na merrte përsipëri rast dhe ne ngelëm në mes të rrugës të pashpresë. Sytë i kishim vetëm te Zoti duke pritur përfshirë mrekulli. Ai që na kishte sjellë deri në këtë pikë, nuk do të na braktiste, ashtu siç ka premtuar: "Sepse vetë

Perëndia ka thënë: 'Nuk do të të lë, nuk do të të braktis'. Bibla Hebrene 13:5b.

Një ditë bashkëshorti im takoi rastësish në anën tjetër të Tiranës një shokun e tij të vjetër mjek. Ai i tregoi që po hapej një spital i ri në Tiranë dhe administratori i spitalit ishte një gjinekolog turk. Im shoq, Mandi, i tregoi problemin që kishim dhe ai i tha të shkonte në spital dhe të takonte mjekun turk përfshirë t'i treguar dosjen e analizave.

Doktor Rehati (kështu quhej gjinekologu turk dhe vërtet solli shumë rehati në jetën tonë) pranoi menjëherë të kujdesej përfshirë. Pas një komunikimi të komplikuar turqisht-anglisht-shqip, ai na premtoi dy gjëra: shtatzenia do të zgjaste nëntë muaj dhe unë nuk do të operohesha nga témhi gjatë kohës së shtatzënisë. Nuk e harroj gëzimin që më pushtoi kur kuptova mrekullinë që po bënte Zoti në këtë situatë të vështirë. Një mjek i huaj, në anën tjetër të qytetit, me një spital ku gjithçka ishte ende e paketuar në qese, po pranonte të merrte përsipëri si pacienten e parë të spitalit, një grua me një shtazani kaq të komplikuar. Ne ndienim dorën e Zotit që kujdesej përfshirë gjithçka.

Më pas jeta ime ishte e mbushur me vizita në urgjencë përfshirë qëtësuar krizat e dhimbshme, antibiotikë herë pas here, analiza çdo dy ditë, eko, konsulta pafund... Isha pacientja e parë dhe e preferuar e "Universal Hospital". Çdo aparaturë u provua së pari mbi trupin tim.



Kur erdhë aparatura e ekografisë, Dr. Rehati vendosi të më bënte një eko përfshirë ecurinë e fëmijës. Ndërsa e kontrollonte me kujdes, ndaloj dhe na tha plot buzëqeshje: "Është vajzë!". Ne qeshëm, sepse tashmë e dinim. Pyetja që pasoi ishte: "Jeni myslimanë?" (Tim shoqi i pëlqen të mbajë pak mjekër) Ne i thamë jo 'dhe ai vazhdoi: "Ortodoksë?". Ne buzëqeshëm përsëri dhe i thamë: "Të krishterë." Atëherë edhe ai buzëqeshi dhe tha: "Maria!". Unë kisha vendosur ta quanim princeshën tonë të vogël Azalea, si lulja e bukur, por emri Maria na tingëlloi kaq i ëmbël dhe kaq i përshtatshëm sa të dy po humenjëherë: "Maria!".



Përfshirë të keq, "Universal Hospital" u mbyll përsëri vetëm pas pak kohe. Kur e morëm vesh, të dy me Mandin u trishtuam, por në të njëjtën kohë u mahnitëm. Ne na duket sikur Zoti hapi dhe mbylli një spital të tjerë vetëm përfshirë mua dhe Marian, dhe nuk mburremi me këtë, por ndihemi të prekur dhe të përular përfshirë kujdesin e pafund që tregoi Zoti përfshirë.

Shtatzënia shkoi fiks 38 javë, sa edhe e para me Samuelin. Lindja, megjithëse me operacion, shkoi shumë mirë. Maria më mahnitë me aromën e ëmbël si biskotë me vanilje. Pas katër muajsh u operova nga témhi dhe, megjithëse tej mase e vështirë, me hirin e Zotit gjithçka kaloi. Prindërit dhe motra ime kanë hequr dorë nga shumë gjëra përfshirë qenë aty përfshirë mua dhe familjen time, duke qenë se unë nuk isha e zonja as përfshirë veten time.

Kur Maria ishte gati dy muajshe shkuam përfshirë takuar Dr. Rehatin dhe i prezantuan vajzën tonë. Sa u gjëzua dhe u prek ai kur dëgjoi që ne i kishim vënë emrin që kishte zgjedhur ai. E si mund të mos e bënim. Ai ishte një nga personat që Zoti kishte përdorur përfshirë të bëre një mrekulli në këtë shtatzëni.

Nga Ana Llakaj



Gjithë jetën tonë kemi përfshirë qenë mirënjohezë ndaj Zotit përfshirë këtë dhuratë të bukur që na solli në një sezoni Krishtlindjeje (Maria lindi në dhjetor), dhe përfshirë familjen time (prindërit dhe motrën time të dashur) përfshirë sakrificat e pafund që kanë bëre dhe vazhdojnë të bëjnë përfshirë.

Edhe përfshirë ju, motrat e mia të dashura të besimit, që keni qenë të pranishme me lutje e fjalë inkurajimi.

Në një ditë të bukur dhjetori Zoti na bekoi me një vajzë dhe ne e quajtëm atë, Maria.